



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 60

Tiranë – E martë, 9 prill 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret Presidentit nr. 129, datë 3.4.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 7407
Dekret Presidentit nr. 130, datë 4.4.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 7407
Dekret Presidentit nr. 131, datë 4.4.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 7407
Dekret Presidentit nr. 132, datë 4.4.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 7407
Dekret Presidentit nr. 133, datë 4.4.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 7408
Dekret Presidentit nr. 134, datë 4.4.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 7408
Dekret Presidentit nr. 135, datë 4.4.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 7408
Dekret Presidentit nr. 136, datë 4.4.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 7409
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 63, datë 26.3.2024	Për delegim kompetence..... 7409
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 66, datë 4.4.2024	Për delegim të kompetencave..... 7409
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 247, datë 29.3.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Letonisë..... 7410

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 248, datë 29.3.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Ukrainës.....	7413
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 249, datë 29.3.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Italisë.....	7415
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 117, datë 29.3.2024	Autorizim i ndihmës shtetërore “Për fuqizimin e grave dhe nxitja e sipërmarrjes”	7417
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. nr. 4615/2, datë 27.3.2024	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare.....	7420
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 153/8, datë 5.4.2024	Për shpronësimin, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Rehabilitimi urban i një pjese të bllokut nr. 3, në qendër të qytetit të Roskovecit (faza 1), Bashkia Roskovec”	7420
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Murat Grami.....	7422



DEKRET
Nr. 129, datë 3.4.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të shkronjës “c” të nenit 92 dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 9 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënen e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tij, shtetasit:

Betim Fetah Vrenezi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 130, datë 4.4.2024

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Nirvana Fadil Almeta (Aliaj)
2. Xhesika Bedri Almeta
3. Gresi Bedri Almeta
4. Antuel Agron Singh-Krause (Ismailaj)
5. Borana Gezim Seiti

6. Daniel (Daniil) Eduard Dajçi (Ntaiti/Dajci)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 131, datë 4.4.2024

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

I lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Oketa Bujar Belegu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 132, datë 4.4.2024

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,



DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Sokol Pashuk Kolgjokaj
2. Rejda Artur Llakaj
3. Anisa Kliti Grazhdani (Kospiri)
4. Dorina Feridon Ibi
5. Elvis Fasli Hyka

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 133, datë 4.4.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Mehmet Ali Muja
2. Jeton Asman Tafa
3. Halil Rexhë Golaj
4. Fitore Arben Kusari
5. Sadije Hysen Krasniqi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 134, datë 4.4.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 16 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Ermelinda Shyqyri Bahollari

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 135, datë 4.4.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 16 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Hakan (Jyrgen) Yilmaz (Julian) Hifzioğlu (Hifzi)
2. Fitret Niazi Dule (Talelli)



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 136, datë 4.4.2024

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Latif Azem Krasniqi
2. Yllka Gani Pelushi (Rexha)
3. Valdete Ismet Aliu (Lubishtani)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

URDHËR
Nr. 63, datë 26.3.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të

vendimit nr. 357, datë 13.6.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e lëshimit të lejeve (*diplomatic clearance*) për hyrjen, uljen e kalimin e mjeteve lundruese ushtarake, të mjeteve fluturuese ushtarake dhe mjeteve të transportit, dhe/ose të blinduara ushtarake të huaja, në hapësirën ajrore, detare dhe territoriale të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, për nënshkrimin e urdhrave të lëshimit të lejeve (*diplomatic clearance*) për hyrjen, uljen e kalimin e mjeteve lundruese ushtarake, të mjeteve fluturuese ushtarake dhe mjeteve të transportit, dhe/ose të blinduara ushtarake të huaja, në hapësirën ajrore, detare dhe territoriale të Republikës së Shqipërisë, zëvendësministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Hantin Bonati.

2. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1, do të ushtrohet nga data e hyrjes në fuqi e këtij urdhri deri në miratimin e një urdhri të dytë.

3. Ngarkohet zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Hantin Bonati, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

URDHËR
Nr. 66, datë 4.4.2024

PËR DELEGIM TË KOMPETENCEVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave si nëpunës autorizues z.Arben Velo, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Prefektit të Qarkut Fier.



2. Kompetencat e deleguara sipas pikës 1, të këtij urdhri, të ushtrohen deri në emërimin e prefektit të qarkut Fier, ose deri në shfuqizimin e këtij urdhri.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet z.Arben Velo dhe Prefektura e Qarkut Fier.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla

URDHËR
Nr. 247, datë 29.3.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E LETONISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Kurzemes	Dienvidkurzemes	Sakas*
Kurzemes	Dienvidkurzemes	Kalëtu*
Kurzemes	Kuldigas	Skrundas*
Kurzemes	Kuldigas	Padures*
Kurzemes	Kuldigas	Ranķu*
Kurzemes	Kuldigas	Alsungas*
Kurzemes	Kuldigas	Īvandes*
Kurzemes	Saldus	Pampālu*
Kurzemes	Talsu	Lībāgu*
Kurzemes	Talsu	Dundagas*
Kurzemes	Talsu	Īves*
Kurzemes	Talsu	Kūlciena*
Kurzemes	Tukuma	Slampes*
Kurzemes	Tukuma	Degoles*
Kurzemes	Tukuma	Vārkavas*

Kurzemes	Tukuma	Smārdes*
Kurzemes	Tukuma	Jaunpils*
Kurzemes	Tukuma	Irlavas*
Kurzemes	Tukuma	Lestenes*
Kurzemes	Tukuma	Džūkstes*
Kurzemes	Ventspils*	
Latgales	Augšdaugavas	Vecsalienas*
Latgales	Augšdaugavas	Demenes*
Latgales	Augšdaugavas	Dvietes*
Latgales	Augšdaugavas	Mājnovas*
Latgales	Augšdaugavas	Salienas*
Latgales	Augšdaugavas	Bebrenes*
Latgales	Balvu	Lazdulejas*
Latgales	Balvu	Kubulu*
Latgales	Balvu	Lazdukalna*
Latgales	Balvu	Šķilbēnu*
Latgales	Balvu	Balvu*
Latgales	Balvu	Tilžas*
Latgales	Balvu	Rugāju*
Latgales	Balvu	Briežuciema*
Latgales	Briežuciema	Kantinieku*
Latgales	Krāslavas*	
Latgales	Līvānu	Rožupes*
Latgales	Līvānu	Turku*
Latgales	Ludzas*	
Latgales	Preiļu	Rušonas*
Latgales	Preiļu	Riebiņu*
Latgales	Preiļu	Silajāņu*
Latgales	Preiļu	Aizkalnes*
Latgales	Preiļu	Saunas*
Latgales	Rēzeknes	Gaigalavas*
Latgales	Rēzeknes	Silmalas*
Latgales	Rēzeknes	Ilzeskalna*
Latgales	Rēzeknes	Gaigalavas*
Latgales	Rēzeknes	Vērēmu*
Latgales	Rēzeknes	Audriņu*
Latgales	Rēzeknes	Bērzgales*
Latgales	Rēzeknes	Dekšāres*
Latgales	Rēzeknes	Nagļu*
Latgales	Rēzeknes	Griškānu*
Montana	Valchedram*	
Rīgas	Siguldas	Krimuldas*
Rīgas	Siguldas*	
Rīgas	Ropazu*	
Rīgas	Salaspils	Salaspils*
Vārmes	Kuldīgas	Vārmes*
Vidzemes	Alūksnes*	
Vidzemes	Cēsu*	
Vidzemes	Gulbenes*	
Vidzemes	Limbažu*	
Vidzemes	Madonas*	
Vidzemes	Smiltenes*	
Vidzemes	Valmieras*	
Vidzemes	Ventspils*	
Vidzemes	Varakļānu*	
Vidzemes	Ogres	Ķeipenes*
Vidzemes	Ogres	Taurupes*
Vidzemes	Ogres	Lauberes*
Zemgales	Dobele*	
Zemgales	Jelgavas	Valgundes*
Zemgales	Aizkraukles*	
Zemgales	Jēkabpils*	

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*



2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Letonisë të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pa infektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartment (zonë) pa prezencë të murtajes afrikane të derrave, ose;

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11, të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajes afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.



2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së, në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15. dhe 15.1.16, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 191, datë 13.3.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në shtetin e Letonisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj



URDHËR

Nr. 248, datë 29.3.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E UKRAINËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Chernihiv	Ripkyns'kyi*	
Chernihiv	Nizhyns'kyi*	
Chernihiv	Kozelets'kyi*	
Chernihiv	Pryluts'kyi*	
Chernihiv	Nosivs'kyi	
Chernivtsi	Hlybys'kyi*	
Chernivtsi	Zastavnets'kyi*	
Kharkiv	Krasnokuts'kyi*	
Kiev	Obukhivs'kyi*	
Kiev	Vyshhorods'kyi*	
Kiev	Boryspil's'ka*	
Kiev	Ivankivs'kyi*	
Kiev	Holosivs'kyi*	
Kiev	Pereiaslav-Khmel'nyts'kyi*	
Kiev	Bilotserskivs'kyi*	
Kiev	Makarivs'kyi*	
Kirovohrad	Kirovohrads'kyi*	
Kirovohrad	Novoukrans'ky*	
Kirovohrad	Svitlovods'kyi*	
Zhytomyr	Zhytomyrs'ka*	
Kherson	Beryslavs'kyi*	
Dnipropetrovsk	Vasyl'kivs'kyi*	
Volyn	Starovyzhivs'kyi*	

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Ukrainës të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pa infektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajes afrikane të derrave, ose;

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.



2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit.

Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajes afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së, në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15. dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajes afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajes afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajes afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit, për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:



a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajes afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajes afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 194, datë 13.3.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajes afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Ukrainës”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR

Nr. 249, datë 29.3.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E ITALISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Lazio	Roma*	
Lazio	Rieti*	
Liguria	Genova*	
Liguria	Savona*	
Liguria	La Spezia	Varese Ligure*
Piemonte	Alessandria*	
Piemonte	Torino*	
Piemonte	Asti*	
Sardegna	Nuoro*	
Sardegna	Sassari*	
Campania	Salerno	Casaleto Spartano*
Campania	Salerno	Casalbuono*
Campania	Salerno	Sanza*
Campania	Salerno	Buonabitacolo*
Calabria	Reggio Di Calabria*	
Lombardia	Pavia*	
Emilia-Romagna	Piacenza*	
Emilia-Romagna	Parma*	

Shënime: Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të



kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Italisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pa infektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajes afrikane të derrave, ose;

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo

periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajes afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) janë vlarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së, në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.



2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15. dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të nenëve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 190, datë 13.3.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Italisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

VENDIM
Nr. 117, datë 29.3.2024

AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE
“PËR FUQIZIMIN E GRAVE DHE
NXITJA E SIPËRMARRJES”

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- Z. Blendi Gonxhja	kryetar;
- Znj. Mimoza Dhëmbi	anëtare;
- Znj. Brikena Qela	anëtare;
- Znj. Inida Methoxha	anëtare;
- Z. Ahmet Maçellari	anëtar;



Në mbledhjen e tij të radhës të datës 29.3.2024 në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe formën e njoftimit’” mori në shqyrtim njoftimin e Bashkisë Tiranë lidhur me planin e dhënies së ndihmës shtetërore për fuqizimin e grave dhe nxitjen e sipërmarrjes.

I. Procedura

1. Bashkia Tiranë, me shkresën nr. 6761, datë 12.2.2024, në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, njoftoi në Komisionin e Ndhmës Shtetërore planin e ndihmës shtetërore të sipërpërmendur, në bazë të vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 125, datë 22.12.2023, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024–2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2024.

II. Përshkrimi i masës

2. *Objektivi*: plani i ndihmës ka si objekt mbështetjen e grave me ide biznesi, të cilat synojnë fillimin ose zgjerimin e një biznesi të vogël ose shumë të vogël në territorin e Bashkisë së Tiranës.

3. *Baza ligjore e njoftimit të planit*: plani i ndihmës shtetërore është miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 125, datë 22.12.2023, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024–2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2024”, në Programin e Kujdesit Social për familjet dhe fëmijët për projektin “Fuqizimi i grave dhe nxitja e sipërmarrjes”.

4. *Kobëzgjatja*: plani i ndihmës do të zbatohet në periudhën 2024–2026.

5. *Dhënësi i ndihmës* dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës është Bashkia e Tiranës.

6. *Përfituesit*: përfitues janë gratë sipërmarrëse që synojnë fillimin ose zgjerimin e biznesit të pavarur të vogël ose shumë të vogël, që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Bashkisë së Tiranës.

7. *Shtërja territoriale*: projekti do të zbatohet në territorin e Bashkisë së Tiranës.

8. *Forma dhe vlera e ndihmës*: vlera e ndihmës shtetërore për periudhën 2024–2026 është 12.500.000 (dymbëdhjetë milionë e pesëqind mijë lekë) lekë për çdo vit, në formën e grantit të

drejtpërdrejtë nga fondet e miratuara për Bashkinë e Tiranës. Çdo përfitues do të mbështetet në shumën 500.000 lekë (pesëqind mijë) lekë.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

9. Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson nëse plani i ndihmës shtetërore për fuqizimin e grave dhe nxitjen e sipërmarrjes, përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, pra nëse plani ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje, të cilat kanë një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfutur në kushte normale të tregut.

10. Neni 4, pika 1 e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, përcakton se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërbortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojnë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

11. Gjithashtu neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë¹, përcakton se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”

12. Ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, konkretisht: a) burime shtetërore; b) avantazhi ekonomik; c) përzgjedhja; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

13. Planin e njoftuar nga Bashkia e Tiranës, do të financohet nga burime shtetërore, respektivisht buxheti i Bashkisë Tiranë. Planin e ndihmës mbështet gra me një ide të qartë biznesi, që synojnë fillimin

¹ Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së stabilizim-asociimit ndërmjet Republikës së Faqe| 7418

Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare”.



ose zgjerimin e biznesit në territorin e Bashkisë së Tiranës, në momentin e aplikimit, duke ofruar avantazh ekonomik për subjektet ekonomike që do të përzgjidhen, pas procedurës së aplikimit. Përparësi do të kenë kategoritë e grave, si: *kyrefamiljare, gratë nga zonat rurale të Bashkisë së Tiranës; gratë me aftësi të kufizuara; gratë nga komuniteti rom dhe egiptian, si dhe gratë nga kategori të tjera*. Plani i njoftuar i ndihmës ka potencial për të ndikuar në konkurrencë dhe në tregti, duke përmirësuar pozitën financiare të disa ndërmarrjeve në treg.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se plani i njoftuar është ndihmë shtetërore.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

14. Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson skemën e njoftuar në përputhje me nenin 8, të ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, i cili parashikon:

“Ndihma “De minimis” është e lejueshme nëse, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin i jepet një ndërmarrjeje, nuk kalon vlerën maksimale për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.”

Mbështetur në kreun II, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.8.2016, “Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës “De minimis”, vlera maksimale e lejuar e ndihmës, si dhe kushtet për autorizimin e ndihmës përcaktohet si vijon:

1. *Ndihma lejohet nëse përmbushen, njëherësh, të gjitha kushtet e mëposhtme:*

a) *vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje të vetme nuk i kalon 14.000.000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, e llogaritur në përputhje me kushtet dhe parimet e parashtruara në kreun 3 të këtij vendimi;*

b) *ndihma është transparente, nëse ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi para dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim risku për konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në kreun 4 të këtij vendimi.*

Në kreun III “Llogaritja e ekuivalentit bruto të grantit”, të VKM-së nr. 605, datë 31.8.2016, përcaktohet se: “1 .Granti dhe subvencioni në të holla janë ndihmë transparente”.

Sa më sipër, bazuar në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 605/2016, ndihma “*De minimis*” lejohet, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) *vlera totale e ndihmës së dhënë një ndërmarrjeje nuk i kalon 14.000.000 (katërmëdhjetë*

milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh. Ky kusht plotësohet duke qenë se ndihma shtetërore për një ndërmarrje është në vlerën e pagës minimale bruto.

b) Ndihma duhet të jepet për një periudhë financiare prej tre vjetësh. Kohëzgjatja e skemës, e cila është marrë në shqyrtim, është tre vjet, duke plotësuar këtë kusht ligjor.

c) Ndihma është transparente. Në këtë skemë, ndihma jepet në formën e grantit.

Sa më lart, Komisioni vlerëson se plani i ndihmës shtetërore është i lejueshëm në përputhje me nenin 8, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 8, 22, dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë skemën e ndihmës shtetërore në formën e grantit për “Fuqizimin e grave dhe nxitjen e sipërmarrjes”, të miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 125, datë 22.12.2023, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024–2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2024”.

2. Çdo përfitues ndihme duhet të nënshkruaj deklaratën e ndihmës “*De-minimis*” dhe të dorëzojë një kopje të deklaratës pranë Bashkisë Tiranë.

3. Bashkia e Tiranës, brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura.

4. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONI I NDIHMËS SHTETËRORE

Kryetar: Blendi Gonxhja

Anëtarë: Mimoza Dhëmbi, Brikena Qela, Inida Methoxha, Ahmet Mançellari

**NJOFTIM****Nr. 4615/2, datë 27.3.2024****MBI HYRJEN NË FUQI TË
MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE**

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për ndërtimin e urës ndërkufitare mbi lumin Buna/Bojana, nënshkruar në Podgoricë, më 27.2.2023, do të hyjë në fuqi më 21 prill 2024.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISËPËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

KËRKESË**Nr. 153/8, datë 5.4.2024****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën “Për shpronësimin, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit ‘Rehabilitimi urban i një pjese të bllokut nr. 3, në qendër të qytetit të Roskovecit (faza 1), Bashkia Roskovec”.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit “truall” dhe “arë” bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Roskovec, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 9,431,003 (nëntë milionë e katërqind e tridhjetë e një mijë e tre) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Kastriot Gurra



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI “REHABILITIMI URBAN I NJË PJESE TË BLOKUT NR. 3, NË QENDËR TË QYTETT ROSKOVEC (FAZA 1)”

NR.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM							SHËNIME (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. Kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja Totale	"Arë" (m2)	"Trrall" (m2)	"Ndëresë" (m2)	Volumi	Faqe	"ARË"			"TRUALL"			VLERA TOTALE (leke)	
														Sipërfaqja (m2)	Çmimi (leke/ m2)	Vlera (leke)	Sipërfaqja (m2)	Çmimi (leke/ m2)	Vlera (leke)		
	A	B	C	C	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	Y	Z
1	Eqerem Et'hem Hajrie Ilirjan Jolldiz Kujtim Mehdije Muharrem Pranvera Rubie Senije Umberto Xheladin Ymid		Risilia Resuli Shehu Kongoli Bedini Kryeziu Hoxha Resuli Kryeziu Risilia Resuli Resuli Kryeziu Resuli	Roskovec	3196	2/282	Trrall	6900	0	6900	0	14	74				6900	494	3,408,600	3,408,600	
2	Eqerem Et'hem Hajrie Ilirjan Jolldiz Kujtim Mehdije Muharrem Pranvera Rubie Senije Umberto Xheladin Ymid		Risilia Resuli Shehu Kongoli Bedini Kryeziu Hoxha Resuli Kryeziu Risilia Resuli Resuli Kryeziu Resuli	Roskovec	3196	2/283	Trrall	9775	0	9755	0	14	75				9775	494	4,828,850	4,828,850	Seksioni D i kartelës së pasurisë: -referenca nr. 2342, datë 22.07.2017: Me Vendim dt. 31.05.2010 të Gjykatës Fier bëhet regjistrimi i padisë Nr. 1230 prot., dt. 19.5.2010
3	Servet	Dervish	Pirra	Roskovec	3196	352/13	arë	3687	3687	0	0	16	123	2675	269	719,575				719,575	
4	Gezim	Servet	Pirra	Roskovec	3196	352/18	arë	2000	2000	0	0	16	121	1286	269	345,934				345,934	
5	Fredi Zana Rudina Resmije Edlira Mira Xhuljeta	Asqeri Elmas Asqeri Asqeri Asqeri	Dyle Dyle Mullaj Rrapushaj Haxhijaj Xhaxhijaj Dyle	Roskovec	3196	349/10	arë	6600	6600	0	0	23	121	476	269	128044				128,044	Seksioni D i kartelës së pasurisë: -referenca nr. 2817, datë 30.12.2013: Mbi këtë pasuri ka një ndërtim të paligjshëm
6	Shtet			Roskovec	3196	162/15	shesh	247	0	247	0	19	204				205	0	-	-	
7	Shtet			Roskovec	3196	2/552	shesh	348	0	348	0	18	99				222	0	-	-	
8	Shtet			Roskovec	3196	2/550	trotuar	1118	0	1118	0	18	97				407	0	-	-	
9	Shtet			Roskovec	3196	349/8	arë	5020	5020	0	0	16	108	4030	0	-				-	
10	Shtet			Roskovec	3196	352/15	arë	467	467	0	0	7	197	160	0	-				-	
11	Shtet			Roskovec	3196	2/551	kanal	398	398	0	0	18	98	398	0	-				-	
12	Shtet			Roskovec	3196	2/839	kanal	327	327	0	0	18	238	114	0	-				-	
13	Shtet			Roskovec	3196	352/14	kanal	2367	2367	0	0	18	144	1019	0	-				-	
	SHUMA															1,193,553			8,237,450	9,431,003	

**KËRKESË**

Shtetasi Qani Grami, kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, shpalljen të vdekur të shtetasit Murat Grami, i lindur më 18.12.1926, në Zhurje-Tiranë, i cili ka ndërruar jetë më 14.5.1999, dhe ekziston ende i paçregjistruar në regjistrin e gjendjes civile.

KËRKUES
Qani Grami

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 80 lekë